



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të

AC-I-16-0174

R.G. Beograd

Ankuesi/ Paditësi

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr.“Agim Ramadani” 23, Prishtinë ***E paditura***

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-3471, të datës 14/07/2016, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 04 tetor 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit, refuzohet si e pa bazuar.

2. Vërtetohet, Aktgjykimi i gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-3471 të datës 14/07/2016.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 02 dhjetor 2013, ankuesi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, ka parashtruar ankesë kundër vendimit nr. PRN078-0023 i datës 13 nëntor 2013, lëshuar nga AKP – Autoriteti i Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore NSH Fabrika e “Y” – Prishtinë (në likuidim), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 1,210.01 Euro për periudhën kohore nëntor 2002 deri në mars 2004. Nga Dhoma e Posaçme ka kërkuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe të shfuqizohet vendimi i atakuar e atij ti njihet e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara.

Në mbrojtjen e parashtruar ndaj kësaj ankesë me datë 18 shtator 2014 e paditura, AKP-ja i propozoi Gjykatës refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe vërtetimin e vendimit të ankimuar të Autoritetit të likuidimit, duke theksuar se kërkesa e ankuesit është e parashkruar. Sipas nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kërkesat për pagat e pa paguara parashkruhen brenda 3 viteve ngase ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor për të kërkuar pagat e tij brenda afatit të parashkrimit. Një kërkesë e tillë ka mund të parashtrohej deri në muajin nëntor 2005 pasi që sipas ankuesit NSH-ja ka ndërprerë pagesën e pagave të tij nga muaji nëntor 2002, andaj Dhomës së Posaçme i ka propozuar që këtë ankesë ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Ankuesi në përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurës, më datë 11 mars 2014, ka mbetur në tërësi sipas pretendimeve të parashtruara në ankesë mbetet pran kërkesë së tij për kompensimin e pagave të papaguara, duke theksuar i takon një e drejtë e tillë dhe për këtë i plotëson kushtet e parapara ligjore. Andaj i propozon gjykatës që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar.

E paditura në kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së ankuesit me datë 17 dhjetor 2014, gjithashtu sikurse edhe në mbrojtjen e parashtruar më herët, i ka propozuar Gjykatës që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoriteti të Likuidimit.

Më 14/07/2016, Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguar i Kolegjit të Specializuar i DHPGJS-së, nxori Aktgjykimin, C-IV-13-3471, me te cilin ankesa ishte refuzuar si e pabazuar dhe vërteton vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN078-0023 i datës 13 nëntor 2013, si të saktë dhe të bazuar në ligj. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegji të Specializuar arsyetoi se vendimi i Autoritetit të likuidimit-AKP-së, sqaron se në baze të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (G. Zyrtare nr. 53/76 i aplikueshëm) përcaktohet se 'Pagesat e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jete e parashtruar në afatin prej 3 viteve.

Ankuesi nuk i kishte bashkangjitur asnjë provë të besueshme me te cilën do të dëshmonte se ai me kohë, për realizimin e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës i është drejtuar ndonjë organi pranë NSH-se. Ai nuk ka dorëzuar prova të tilla, ai vetëm pretendon se një e drejtë e tillë i takon. Ankuesi nuk ka vërtetuar se ka qenë punëtor gjegjësisht se ka punuar në NSH, deri në fillimin e procesit të likuidimit 27/06/2013.

Më 14/07/2016, paditësi (më tutje ankuesi) ka parashtruar ankesë, kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-3471, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontesti më, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së të drejtës materiale. Sipas ankuesit detyrimi i punëdhënësit për pagë ndaj punëmarrësit fillon nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ky obligim lind nga neni 72 paragrafi 3 i Ligjit për Punën nr. 03/L-212. Ndërsa marrëdhënia e punës është ndërprere me rastin e Njoftimit nga ana e AKP-së. Nga ky moment fillon të rrjedh afati i parashkrimit të kërkesës. Më tutje ankuesi pohon se gjykata duhet të marrë në konsideratë edhe diskriminim e përkatësisë serbe pas

vitit 2004 si ka vepruar në rastin SCEL-11-0022. Gjykata me qëllim të vërtetimit të fakteve duhej të mbante seancën dëgjimore të cilën nuk e ka bërë. Ankuesi kërkoi nga Kolegji i Apelit të anulojë aktgjykimin e ankimuar dhe të detyrojë të paditurën kompensimin e shumës prej 1.210.01 euro në emër të pagave të pa paguara.

Më 21/09/2016, AKP-ja parashtroi përgjigje ne ankesë. AKP-ja pohon se argumentet e ankuesit janë të pabazuara dhe aktgjykimi ankimor i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar dhe vendimi i autoritetit të Likuidimit duhen të vërtetohen. Për më tepër AKP-ja ka pohuar se qëndron pranë parashtresave të mëparshme. Apeluesi nuk ka nuk ka parashtruar dëshmi të re në mbështetje të pretendimeve të tija. Ndërsa siguria juridike kërkon që parashkrimi nuk duhet të vihet në dyshim në të kundërtën shkakton paqartësi dhe konfuzion.

Për arsyet e cekura me larte AKP-ja, kërkon që të refuzohet Apeli si i pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa është e pranueshme por e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Kolegji i Apelit ka vendosur që të mos vazhdojë me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi në tërësi pretendimet ankimore, provat në shkresat e lëndës dhe aktgjykimin e ankimuar gjeti se ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Specializuar i DHPGJSK-së e kishte refuzuar ankesën si të pa bazuar dhe e kishte vërtetuar Vendimin e AKP-së - Autoritetit të Likuidimit nr. vendimit nr. PRN078-0023 i datës 13 nëntor 2013 si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Sipas Kolegjit

të Specializuar, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (G. Zyrtare nr.53/76 i aplikueshëm) përcakton se: "*Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për 3 vjet*". Ankuesi, ankesës nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë të besueshme me të cilën do të dëshmonte se ai me kohë i është drejtuar ndonjë organi të NSH-së, për realizimin e të drejtës së pretenduar nga marrëdhënia e punës. Ai gjithashtu nuk ka dorëzuar asnjë provë se ndonjëherë i është drejtuar ndonjë gjykatë kompetente me padi lidhur me këtë çështje, gjegjësisht 3 vite pasi që NSH-ja ka ndërprerë pagesën e të ardhurave personale të tij.

Kolegji i Apelit vlerëson se në rastin e ankuesit nuk ka ndërprerje të parashkrimit siç pretendon pa bazë ai në ankesë. Kërkesa e tij e dorëzuar në Zyrën e UNMIK-ut në Beograd nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, në bazë të nenit 388 të LMD-së, pasi që ajo kërkesë nuk është dorëzuar tek organi kompetent. Ankuesi së paku me postë ka mundur ta dërgon padinë në gjykatë ose tek AKM-ja, mirëpo ai vet ka zgjedhur ta dërgon padinë në Zyrën e UNMIK-ut, që nuk ishte veprim i duhur i tij për ta ndërprerë parashkrimin e kërkesës.

Kolegji i Apelit nuk e pranon pretendimin e ankueses se afati i parashkrimit rrjedhë nga dita kur vendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës bëhet i plotfuqishëm, tashmë kërkesa ishte e parashkruar, dhe njoftimi i AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk mund ta ndërpresë parashkrimin për një kërkesë që tashmë ishte parashkruar. Një qëndrim të tillë për një kërkesë të njëjtë të një ankuesi të së njëjtës NSH, Kolegji i Apelit e ka marrë edhe në rastin AC-I-16-0189.

Neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar(G. Zyrtare nr.53/76) në të cilin ishte bazuar vendimi refuzues, ishte shfuqizuar me Ligjin e Punës nr. 03/L-212 i cili ka hyrë në fuqi më 01 nëntor 2010, dhe i cili në dispozitat kalimtare përcakton saktë shfuqizimin e të gjitha ligjeve ekzistuese të punës në Kosovë. Megjithatë Ligji i Punës nr. 03/L-212 nuk parasheh afate të parashkrimit të pagesave të ardhurave. Prandaj duhet të aplikohen rregullat e përgjithshme të parashkrimit për detyrimet civile. Këto rregulla mund të gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD) nr. 690 i datës 30 mars 1978, i cili ishte në fuqi deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD). Ndërsa në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i

LMD-së parashkrimi i kërkesave periodike siç janë pagat, është tri (3) vjet: njëjtë sikurse në nenin 353, paragrafi 1, gjegjësisht në nenet 352 dhe 354, paragrafi 21 dhe 2 i LMD-së. Me sa po shihet afati i parashkrimit për paga ka qenë dhe ende është tre (3)vite.

Nga marsi i 2005 deri më 2013, kur është parashtruar kërkesa pranë AL të AKP-së, kanë kaluar më shumë se 3 vjet. Kjo është arsyeja pse kërkesa e paditësit është parashkruar dhe ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi në ankesë ka pohuar se nuk është mbajtur seanca dëgjimore lidhur me padinë e saj. Kolegji i Apelit vlerëson se nuk ishte gabim që nuk është mbajtur seanca dëgjimore pasi që ankuesja nuk ka treguar se çka do të mund të ndryshohet po të mbahej kjo seancë

Andaj, Kolegji i Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që tashmë ankuesi më 16/09/2016 ka paguar taksën gjyqësore në shumën prej 20 eurosh, ai nuk ngarkohet me taksa shtesë nga Kolegji i Apelit.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 04 tetor 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues _____

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIT

Ju lutem të dorëzoni këtë Aktgjykim(përfshirë përkthimin në gjuhën Serbe) tek:

- Palët
- Anëtarët e Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK-së në lëndën C-IV.-13-3471

Ilmi Bajrami, Gjyqtari Kryesues